

CAGLIERO 11



Buletini i Animimit Misionar Salezian

Publikim i Dikasterit për Misionet për Bashkësitë Saleziane dhe miqtë e misionit Salezia

Fort të dashur Salezianë dhe miq të misionit salezian, në këtë fillim të janarit të vitit 2013 ju uroj një vit plot Dritë!

Jemi duke jetuar Vitin e Fesë, një periudhë hiri. Porsi bijë të vërtetë të Don Boskos duam të jetojmë gjithmonë me një ndjenjë të thellë Kishtare. Tema e Ditës Misionare saleziane, 'Rrugëtimi i fesë në Afrikë', na ndihmon të ecim brenda Vitit të Fesë: rrëfimet e katekumenatit, modele të katekistëve, na ndihmojnë t'i frymëzohemi bashkësive të reja të krishtera.

Falënderoj me gjithë zemër të gjithë bashkëvëllezërit që ndodhen në Afrikë që na kanë afruar me dinamikat e një "mushkërie të madhe shpirtërore për njerëzimin" në mes të botës që përballet me një krizë feje dhe shprese (*Benedikti XVI Africae Munus*, 13).

Në Vitin e Fesë ju ftoj ta jetoni lutjen për Ditën Misionare Saleziane 2013: «Jezus, ec me mua, Jezus qëndro me mua... Më bëj dëshmitarin tënd!».

Václav Klement

D. Václav Klement, SDB
Këshilltar për Misionet

Një "kairos" për Afrikën dhe Madagaskarin

Një gjë që i bën përshtypje të gjithë atyre që vizitojnë Afrikën është numri i kinezëve të pranishëm në këtë kontinent. Dikush ka përllogaritur se janë të paktën 25 milionë kinezë në Afrikë! Disa prej këtyre, në mënyrë të veçantë të rinjtë, frekuentojnë qendrat tona dhe oratorët kryesisht për sportin dhe ndonjëherë edhe për të "shijuar" disa nga kremtimet tona liturgjike. Ndoshta ndonjëherë shndërrohen në shënjestër të shakave tona. Gjithsesi, nëse e analizojmë më thellë këtë situatë me një ndjeshmëri misionare, bëhet krejtësisht e qartë që shumë prej tyre, për të mos thënë pjesa më e madhe, nuk e kanë dëgjuar Ungjillin dhe as Jezu Krishtin.

Është një ko incidencë e bukur që nëntorin e kaluar (nga 5 deri 9) ditët e studimit mbi shpalljen e Krishtit në Afrikë dhe Madagaskar, janë zhvilluar në Adis Abeba, në Etiopi, dhe që Dita Misionare Saleziane e këtij viti 2013 përqendrohet mbi shpalljen e Krishtit në Afrikë. Këto dy evenimenti na shtojnë të shikojmë përreth nesh me zemrën visionare të Don Boskos!

Me sytë misionare të Don Boskos shikojmë përreth nesh "urgjencën për t'ia shpallur Lajmin e Mirë miliona personave në Afrikë që nuk janë ungjillëzuar ende" (*Ecclesia in Africa*, 47). Është e rëndësishme, prandaj, të ngjallim interes për Jezu Krishtin mes atyre që nuk e njohin, dhe ta rigjallërojmë fenë e të krishterëve afrikanë që janë bërë të vakët në fenë e tyre.

Papa Benedikti XVI ka ftuar të rimerret "zelli e fillimive të ungjillëzimit të kontinentit afrikan" (*Africae munus*, 164). Ky zell misionar i hapë sytë tanë mundësive misionare të pranishme së popullit kinez në Afrikë. Në fakt, këtu i kemi të gjitha mundësitë për të shpallur Ungjillin që Kisha në Kinë nuk i ka! Testamenti i Ri përdor termin "kairos" për të përshkruar "kohën e përcaktuar në projektin e Hyjit", momenti në të cilin Hyji vepron (si për shembull, në Ungjillin e Markut 1,15). Jam i bindur se duhet t'i përgjigjemi kësaj kohe të vizitës së Hyjit. Është për këtë arsye që i kam ftuar inspektorët e Rajonit afrikan, gjatë takimit tonë të fundit, t'ia bëjë të njohur atë çka Hyji është duke na thënë sot përpara një pranije të fortë të popullit kinez. Jam i sigurt se të korrura të bollshme na presin nëse i përgjigjemi me guxim misionar këtij "kairos" për Kishën dhe Kongregatën në Afrikë dhe Madagaskar!

P. Guillermo Basañes, SDB

Dita Misionare Salesiane 2013



Dita Misionare Saleziane e përvitshme, kremtohet në një datë të zgjedhur nga çdo Inspektor, dhe synon të ndihmojë çdo salezian, çdo bashkësi edukative-baritore dhe krejt Familjen Saleziane për të njohur angazhimet e ndryshme misionare të Kongregatës, t'i hapë sytë realiteteve të reja misionare, të tejkalojë çdo lloj tundimi për t'u mbyllur brenda territorit ose kontekstit në të cilin ndodhet dhe të kujtojë frymën universale të përshtypjes saleziane. Këtë vit tema është: "Rrugëtimi i fesë në Afrikë". Kremtimi i Ditës Misionare Saleziane është pikë kulmore (pas një itinerari edukativo-baritore nëpërmjet nismave të ndryshme të zhvilluara në disa javë) dhe shprehje e shpirtit misionar e gjithë Bashkësisë Edukative-Baritore të mbajtur të gjallë gjithë vitin.

Video: http://www.sdb.org/en/SDB_webTV/Sectors/SMD_2013



Me origjinë nga Republika Demokratike e Bongos, kam lindur në një familje katolike. Kam tatua Jezusin me nismë të nënës sime... Një ditë, ndërsa po ecja përballë një kishë, nëna ime më tha: "Biri im, eja të shkojmë të përshëndesim Jezusin në Kishë...". Nuk po kuptoja asgjë; me të hyrë në kishë e pashë tek po gjunjëzohej dhe të bënte shenjën e kryqit. Ky gjest më shënjoji, dhe pikërisht nga ai moment fillova të ndjeja praninë e Hyjit në jetën time.

Periudha mes vitit 1990 dhe 1992 qe një moment shumë i vështirë. Në Vendin tim shumë fëmijë u gjetën të braktisur. Duke i takuar këto fëmijë në rrugë, në zemrën time filluan të lindnin disa pyetje: «Përse vuajnë këto fëmijë? A mos vallë janë braktisur nga Jezusi?». Fjala e Jezusit u rikthye në thellësi të zemrës sime: "Çkado bëtë për njërin ndër këta vëllezërit e mi e më të vegjël, e bëtë për mua" (Mateu 25,40). Kisha vendosur të sakrifikoja jetën time për t'i shërbyer fëmijëve që vuajnë. Në këtë mënyrë pati fillësë edhe thirrja ime misionare.

Me të mbërritur në para rishtarinë saleziane gëzimi im ishte i pamasë kur Inspektori më dërgoi të punoja me fëmijët në vështirësi. Pastaj bashkëndava me drejtorin tim thirrjen misionare që ndjeja brenda zemrës. Drejtori më këshilloi ta shprehja këtë dëshirë misionare sapo të kisha filluar rishtarinë. Gjatë periudhës së rishtarisë **Magjistri** më inkurajoi fortësisht në këtë thirrje dhe me këshilloi ta vazhdoja. Gjatë studimeve të filozofisë i shkrova Rektorit Madhor: Don Vecchi pranoi kërkesën time dhe më dërgoi në Inspektorinë Afrikane, në pjesën frankofone lindore, që është e përbërë prej 7 Shtetesh. Kam punuar në Togo për dy vite gjatë **praktikës**. Pas shukurimit meshtarak kam qenë përgjegjës i shtëpisë së fëmijëve në vështirësi dhe i baritores rinore të Abidjan-it, **Bregut të Fildishtë**. Nga viti 2010, gjindem në Ouagadougou, Burkina Faso, mes fëmijëve të Belleville, ku kemi nisur një prani të re saleziane.



Gjatë këtij rrugëtimi misionar, kam hasur vështirësi të ndryshme që bëjnë pjesë në këtë gëzim të madh që është në shpalljen e Jezusit: kam pasur vështirësi të përshtatem qoftë me gjuhën, qoftë me klimën.

Por gëzimi im më i madh ka qenë të takoja vëllezërit dhe motrat e Afrikës lindore, që janë shumë të ndjeshëm ndaj një afrikani që është misionar në Afrikë. Më ka mbetur në mendje dëshmia e disave prej tyre që shpreheshin me fjalë të tilla si: «Ti je afrikan dhe ti e lë Vendin tënd, prindërit e tu, miqtë e tu dhe vjen të qëndrosh dhe të jetosh me ne. Duke bërë këtë gjë ti je me të vërtetë vëlla dhe bir i yni. Mos ki frikë, ne jemi me ty në këtë mision që Hyji të ka besuar mes nesh».

Do të doja të ftoja të rinjtë Salezianë të mos kenë frikë t'i përgjigjen thirrjes misionare që Hyji i bën atyre: Hyji ka nevojë për ty në këtë botë, dëshiron që ju të jeni dëshmitarë deri në kufinj të botës. Jetoni misionin kudo ndodheni. Jini faqja e Ungjillit që tërheq të rinjtë në jetën misionare!

D. Albert Kabuge
kongolez, misionar në Burkina Faso

KËRKOHEN MISIONAR TË RINJ > OQËANI

Inspektorja	>	AUL - Australia
Gjuha	>	Anglisht, Gjuha e të migruarve
Shënime	>	Shoqëri e shekullarizuar, multikulturore. Pak Salezianë të rinj, vepra edukuese (shkollë, qendër rinore), baritore të të migruarve.



Synimi Misionar Salezian

ILM - Inspektorja e Lindjes së Mesme

Për bashkëvëllezërit e pranishëm në shtatë Shtetet e Inspektorisë ILM dhe për bashkëpunëtorët e tyre laikë, në mënyrë që të mund të kryejnë mes vështirësive të shumta, me fe, guxim dhe durim, misionin salezian si edukatorë dhe ungjillizues.

Një Inspektori e lindur me praninë e Atë Antonio Belloni në Tokën e Shenjtë (1893), të vendosur pastaj në Egjip (1896), Turqi (1903), Iran (1937), Siri (1948), Liban (1952). Në Janar të vitit 2012 ILM-ja mikëpret inspektorin e parë me origjinë arabe, atë Munir El Rai, sirian. Tani janë 33 bashkëvëllezër vendas (Egjip 15, Siri 13, Liban 3, Iran 1, Irak 1) dhe 75 misionarë të ardhur nga Shtetet e mëposhtme: Itali 42, Indi 7, Poloni 6, Vietnam 3, Spanjë 2, Maltë 2, Kili 1, Haiti 1, Filipine 1, Kenia 1, Mali 1, Meksikë 1, Paraguaj 1, Slloveni 1, Timor Lindor 1, Venezuelë 1, SHBA 1; pjesa më e madhe e tyre janë të moshës së tretë. Shumëllojshmëria e gjuhëve, kulturave, besimeve dhe riteve të ndryshme të krishtera, vështirësitë që rrjedhin si pasojë e origjinës shoqërore dhe situata e konflikteve të ndryshme me armë e bëjnë misionin tonë edukativo-ungjillizues aspak të lehtë.

